



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:146117

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06550596

**P.nr.58/22**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL**, nga gjyqtarja e vetme Sabaheta Kurteshi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Gjelbrim Gërdellaj, **në lëndën penale ndaj të pandehurit A. (S.) Q. nga Dragashi, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës, nr. 06/L-074, sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1251-3/22 të dt. 18.07.2022, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen për Ndërmjetësim me shifrën NDM.nr.216/24 të dt. 02.08.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prizren, në mes të të pandehurit A. Q. dhe të dëmtuarës K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” sh.a., e përfaqësuar nga Zyrtarja ligjore A. C. nga Prizreni, konform nenit 357 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së dhe nenit 14 të Ligjit për ndërmjetësimin Nr.06/L-009, jashtë seance me dt. 04.12.2024 merr këtë:**

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësimin, e lidhur ndërmjet të pandehurit A. Q. nga Dragashi dhe të dëmtuarës K.R.U. “Hidroregjioni Jugor SH.A., marrëveshje e lidhur në Qendrën e ndërmjetësimin në Prizren, me numer te rastit Ndm.216/24 të dt. 02.08.2024.

**II. HUDHET POSHTË** Aktakuza e Prokuroris Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm me PP/II.nr.1251-3/22 të dt. 18.07.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit **A. (S.) Q. nga Dragashi**, i lindur më..., me nr. Personal..., i biri i S., dhe nënës Z., i martuar, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës.

- Për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KP-së.

**IV.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1251-3/22 të dt. 18.07.2022, ka paraqitur Aktakuzën kundër të pandehurit A. Q. nga Dragashi, me nr. personal 2000770607, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 i KP-së.

Gjykata me dt. 29.05.2024, ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin shqyrtim ka prezentuar Prokurori i shtetit Atnor Skoro nga Prizreni, përfaqësuesja e të dëmtuarës S. Zh. si dhe i pandehuri A. Q.

Në këtë shqyrtim fillestar pikërisht i pandehuri i ka propozuar gjykatës që kjo çështje penale të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit dhe pas dhënies së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit që këtë çështje ta dërgoj në marrëveshje në procedurë të ndërmjetësimit, gjykata ka marr aktvendim ku ka aprovuar propozimin e të pandehurit dhe këtë çështje penale juridike konform ligjit për ndërmjetësimin dhe dispozitat ligjore të KPPK-së, me dt. 03.06.2024, gjykata propozimin bashkë me shkresat e lëndës i ka dërguar në Qendrën e Ndërmjetësimitm përmes kordinatorit të Gjykatës.

Gjykata me dt 26.08.2024 ka pranuar shkresat e lëndës ku bashkangjitur ka qenë edhe marrëveshja për zgjedhjen e ndërmjetësuar që mban shenjën Ndr.nr.216/24 të dt. 02.08.2024, marrëveshje e përpiluar dhe e nënshkruar prej palëve prezente, tek Qendra e ndërmjetësimit në Prizren. Gjykata pas shiqimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësimin, ka konstatuar se palët në procedurë, pa ndonjë kërcënim, me vullnetin e tyre e kanë arritur marrëveshjen si në vijim: Pala B, i pandehuri ka deklaruar se i vjen keq për rastin që ka ndodhur, dhe që i ka shkaktuar dëm material palës “A” dhe se pajtohet me këtë marrëveshje të ndërmjetësimit për pagesën e dëmit material si në marrëveshje, shumën totale prej 188.14 euro, të cilën shumë do ta paguaj me 6 (gjashtë) këste mujore, ku pagesa e kështit të parë është bërë me dt. 02.08.2024, ndërsa pagesat e kësteve tjera dhe atë në shumë prej 31.35 duhet të bëhet për muajt vijues dhe atë prej datës 1-5 të muajve pasues deri në pagimin total të borxhit. Pala “A” hjekë dorë nga ndjekja penale ndaj palës “B”, dhe duke u bazuar në faktin se pala “B” do ta përmbushë obligimin sipas marrëveshjes. Me këtë rast palët e konsiderojnë rastin e mbyllur me këtë marrëveshje të arritur në procedurë të ndërmjetësimit. Deklaron se pajtohet me këtë marrëveshje të ndërmjetësimit e gjithashtu deklarën se pajtohet që pagesa e borxhit dhe atë në shumë prej 188.14 të bëhet me 6 këste sipas muajve vijues të cekur në dispozitiv të kësaj marrëveshje.

Gjykata vlerësoi se marrëveshja për ndërmjetësim pasqyron vullnetin e lirë të palëve dhe është e lidhur në pajtim me ligjin andaj duke vepruar në pajtim me nenin 15 par.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësim nr. 06/L-009, e aprovoi këtë marrëveshje e cila pas aprovimit nga Gjykata, kjo marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 455 par. 1 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lartë konform nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPPRK-së lidhur me neni 15.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH –  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:146117, 04.12.2024**

**Gj y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankese.